

**VENDIM**  
**Nr. 673, datë 22.11.2017**  
**PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË**  
**INFORMACIONIT<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.36, datë 24.1.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. Dispozita të përgjithshme**

1. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, më poshtë AKSHI, është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit.

2. AKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë *hardware* dhe *software* në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet jobuxhetore për të cilat do të përdoren tarifa shërbimi.

3. AKSHI ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK, duke përjashtuar fushën e komunikimeve elektronike. AKSHI është ofrues i shërbimeve TIK dhe i shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike.

4. Për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, shtete dhe organizata të tjera ndërkombëtare, AKSHI ndjek dhe zbaton politikat dhe strategjitë e hartuara nga DSIK-ja për këtë qëllim, e cila kryen mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

**II. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e AKSHI-t**

5. AKSHI, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj, ushtron kompetencat kryesore, si më poshtë vijon:

a) Promovon teknologji të reja, harton strategji dhe planveprime për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik *e-GOV*.

b) Zhvillon politika e strategji në sektorin e shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK), si dhe nxit investimet në fushën e SHI-së.

c) Bashkërendon programe në fushën e SHI-së, si edhe jep kontribut në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

ç) Garanton një nivel të lartë të sigurisë kibernetike dhe zgjidhjet ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike duke bashkërenduar me CSIRT, si ekipi përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

---

<sup>1</sup> VKM nr. 673, datë 22.11.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.209, 4 dhjetor 2017.  
VKM nr. 36, datë 24.1.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, 25 janar 2018.

d) Është autoritet rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore.

dh) Riorganizon dhe menaxhon strukturat përgjegjëse TIK, në institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

e) Ofron shërbime të përqendruara nëpërmjet teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike, për administratën shtetërore, qytetarët, bizneset, të cilat janë të detajuara sipas listës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

ë) Ofron shërbimin e nënshkrimit elektronik, së bashku me pajisjen përkatëse dhe vulën digjitale, për organet dhe institucionet e administratës publike dhe subjektet private, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Përcaktimi i tarifave sipas kësaj shkronje bëhet me propozimin e AKSHI-t dhe miratimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.

f) Ngre dhe ofron shërbime elektronike për sportelet fizike të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të cilat ofrojnë shërbime publike.

g) Ofron sisteme IT, infrastrukturë *hardware* dhe TIK për ADISA-n, në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike në sportele fizike nga ana e saj.

gj) Ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

h) Ndërmerr, kryesisht ose mbi bazën e kërkesave të institucioneve të administratës shtetërore të interesuara, nisma për procesin e riinxhinerimit elektronik të shërbimeve nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, në varësi të nevojës për përmirësim të procedurave, riorganizimit të proceseve të punës, me qëllim thjeshtimin, rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të administratës publike, si edhe të zhvillimeve teknologjike.

i) Organizon, kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet *software* dhe *hardware*, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, për institucionet në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, sipas listës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

j) Organizon, kryen prokurimet e përqendruara dhe lidh kontratat për pajisjet TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet sipas listës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. AKSHI, në ushtrim të veprimtarisë së saj, kryen edhe këto detyra e përgjegjësi të veçanta, si më poshtë vijon:

a) Merr pjesë në hartimin e strategjive të agjendës digjitale.

b) Bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së agjendës digjitale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private.

c) Përcakton standardet shqiptare të TIK-ut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

ç) Përcakton standardet shqiptare të shërbimeve publike elektronike (*e-shërbime*), në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore dhe subjektet private.

d) Ofron shërbimet e autentifikimit, nënshkrimit elektronik dhe vulës digjitale për organet dhe institucionet e administratës publike dhe subjektet private.

dh) Ofron shërbimet e përqendruara të TIK-ut për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ky shërbim i ofrohet edhe institucioneve të tjera publike, me kërkesë të vetë institucionit.

e) Ofron shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike me bazat e të dhënave të ndërlidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit, si dhe të shërbimeve elektronike në portal dhe në modulën e tij për

nëpunësit e administratës publike, për çdo person fizik dhe juridik që ushtron funksionin në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.

ë) Mundëson përmes platformës qeveritare të ndërveprimit shkëmbimin e të dhënave të sistemeve elektronike (baza të dhënash shtetërore) në përputhje me kushtet e siguruara, si vijon:

- Çdo sistem elektronik (bazë të dhënash shtetërore) ka të drejtë të përdorë shërbimin e dërgimit të të dhënave parësore (të cilat janë informacione specifike, të mbledhura në përputhje me aktin e krijimit të bazës së të dhënave) nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, duke pranuar transmetimin e këtyre të dhënave, nga administratori i kësaj platforme.

- Transmetimi i të dhënave merret përsipër nga platforma në kohë reale dhe pa të drejtë përpunimi për shpërndarjen të marrësi i tyre me një mesazh të dhënash që është shënuar në mënyrë elektronike dhe përmban datën dhe kohën e marrjes së tyre.

f) Administron kodin burim të çdo sistemi, si përfaqësues i pronarit shtet që është Këshilli i Ministrave.

g) Nxjerr nga përdorimi një sistem dhe/ose një infrastrukturë *hardware* dhe/ose *software*.

gj) Bashkërendon projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike.

h) Jep mendim të detyrueshëm për institucionet publike, me qëllim zbatimin efektiv dhe bashkërendimin e projekteve në fushën e TIK-ut.

i) Përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ai organizon prokurimin e përqendruar për pajisjet TIK, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, dhe për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të cilat, jo më vonë se data 30 qershor, i dërgojnë kërkesë me shkrim AKSHI-t për nevojat e tyre për projektet dhe pajisjet TIK për vitin pasardhës.

j) Jep mendim për institucionet e tjera të administratës publike, me kërkesë të tyre, për:

- specifikimet teknike të prokurimeve, që do të realizohen me fonde të buxhetit të shtetit, hua dhe/ose grante të dhëna nga donatorë;

- procedurat që kanë lidhje me projekt-propozime/projekte të ndryshme, dhurata apo ndihma materiale.

AKSHI jep mendim brenda afatit prej 20 ditësh pune nga data e marrjes së dokumentacionit të sipërpërmendur.

k) Zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën *hardware* dhe *software* të shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet nga:

- portali unik qeveritar *e-Albania*, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë: qeveri – qeveri; qeveri – qytetar; qeveri – biznes;

- sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;

- Regjistri Kombëtar i Shërbimeve Qeveritare *online*;

- Regjistri Kombëtar i Bazave të të Dhënave Shtetërore;

- Regjistri Kombëtar i Marrëveshjeve qeveri – qeveri; qeveri – privat; qeveri – partnerë ndërkombëtarë;

- qendra e të dhënave qeveritare (*Datacenter*-i qeveritar);

- qendra e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së *Datacenter*-it qeveritar, në rast fatkeqësie (*Disaster Recovery Center*);

- qendra e vazhdueshmërisë së punës (*Business Continuity Center*, BCC) dhe qendra e ruajtjes së informacionit (*Back-up Center*), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje, 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës;

- rrjeti qeveritar (*Govnet*);

- çelësi publik dhe menaxhimi i certifikatave digjitale për administratën publike dhe subjektet private. Me garancinë financiare si institucion qeveritar, AKSHI siguron pajtueshmërinë me nenin 19, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar;

- Sistemi i administrimit të dokumentit elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik;

l) Rregullon dhe koordinon procesin e regjistrimit të bazës së të dhënave shtetërore, me qëllim ekspozimin e të dhënave parësore, në platformën qeveritare të ndërveprimit, auditimin e bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

ll) Merr pjesë në hartimin e strategjisë ndërsektoriale të agjendës digjitale dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj.

m) Merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike *e-GOV*, si një nga komponentët e rëndësishëm të infrastrukturës TIK.

n) Merr pjesë në përgatitjen e akteve rregullatore, ligjore e nënligjore, për zhvillimin e SHI-së dhe të TIK-ut.

nj) Ndihmon në hartimin e ndryshimeve dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e komunikimeve elektronike *e-GOV*.

o) Mbështet dhe bashkërendon projektet për digjitalizimin e bazës ligjore të fushës, të dokumentacionit, të arkivave, të bibliotekave etj.

p) Nxiti dhe mbështet zhvillimin e biznesit *online (e-business)*.

q) Nxiti dhe mbështet politika për zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut dhe të investimeve private në këtë fushë.

r) Promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet *online*.

rr) Promovon dhe mbështet rritjen e aftësive për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga qytetarët.

s) Bashkëpunon në fushën e SHI-së me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

sh) Nxiti veprimtaritë e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kuadër të detyrimeve, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike *e-GOV*.

t) Nxiti, në bashkëpunim me DSIK-në, veprimtarinë për komunikimin elektronik *e-GOV*, në kuadër të detyrimeve që lindin nga marrëveshjet ndërkombëtare, NATO dhe BE, për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

th) Aplikon, zhvillon dhe menaxhon projekte në fushën TIK, që mbështeten nga financime apo donacione të huaja.

u) Përcakton standarde të zbatueshme për institucione të tjera publike që kërkojnë ofrimin e shërbimeve nga agjencia.

v) Kërkon ndryshimin e sistemeve dhe të proceseve elektronike në to, si dhe krijimin e shërbimeve të reja elektronike, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike sa më cilësore nga portali qeveritar *e-Albania*.

x) Monitoron përdorimin dhe mbarëvajtjen e portalit *e-Albania*, të përshtatur për nëpunësit e administratës publike, institucionet publike dhe për çdo person fizik a juridik privat, që ushtron një funksionin publik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

xh) Harton planin e transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve që preken nga fusha e veprimit të këtij vendimi.

y) Administron nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve të përmendura në shkronjën “I”, të pikës 6, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi. Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive.

z) Për prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, me vlerë nën kufirin monetar të prokurimeve

me vlera të vogla, do të merret miratimi i AKSHI-t për specifikimet teknike.

7. AKSHI mundëson ekspozimin e *web service*-ve të bazave të të dhënave me qëllim aksesimin e të dhënave parësore për subjektet e interesuara për ndërveprimin në platformën qeveritare të ndërveprimit.

8. Në kuadër të monitorimit për përdorimin dhe mbarëvajtjen e portalit *e-Albania*, AKSHI merr masa administrative ndaj shkelësve apo keqpërdoruesve, sipas legjislacionit në fuqi.

### III. Funksionimi dhe organizimi i AKSHI-t

9. AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas listës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë njësitë e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK).

11. Njësia e teknologjisë së informacionit e të komunikimit është përgjegjëse për:

a) administrimin e infrastrukturës, sistemeve dhe shërbimeve TIK në ministritë e linjës dhe në institucionet e varësisë, në rast se nuk detajohet ndryshe. Për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, administrimi i kësaj infrastrukture kryhet sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;

b) ofrimin e shërbimit të asistencës të nivelit 1, për infrastrukturën fizike, pajisjet TIK dhe funksionimin e sistemit për institucionin ku funksionon njësia.

12. AKSHI drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie.

13. Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit.

14. Pranë AKSHI-t krijohet dhe funksionon bordi për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (BTIK), si organ këshillimor për zhvillimin e politikave e të strategjive kombëtare për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Bordi asistohet në punën e tij nga një sekretariat teknik.

15. Përbërja dhe rregulla më të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të BTIK-së dhe sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

16. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKSHI-it rregullohen me Kodin e Punës.

17. Struktura dhe organika e AKSHI-t miratohen me urdhër të Kryeministrit.

### IV. Dispozita kalimtare dhe të fundit

18. Institucionet e përmendura në shkronjën “i”, të pikës 6, të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t, 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse.

Kalimi do të bëhet në dy faza. Faza e parë do të jetë brenda datës 31 dhjetor 2017, sipas listës nr. 2. Faza e dytë brenda datës 30 qershor 2018. Për mënyrën e kalimit dhe planin e veprimit, AKSHI përgatit një marrëveshje kuadër dhe protokoll të punës për ofrimin e shërbimeve, e cila nënshkruhet sipas veçantive përkatëse nga çdo institucion i përmendur në listën nr. 2.

19. Për sistemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.

20. Harton planin e transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve që preken nga fusha e veprimit të këtij vendimi.

21. Për sistemet IT që janë ngritur dhe funksionojnë në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, AKSHI njih dhe zbaton të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga këto marrëveshje.

22. Për kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë, për të cilat nuk është lidhur kontrata për vitin 2017, si dhe për nevojat për projektet dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për vitin 2018, institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave të dërgojnë kërkesat e tyre pranë AKSHI-t, brenda 1 jave nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

23. Strukturat përgjegjëse TIK bëhen pjesë të strukturës së AKSHI-t. Punonjësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kalojnë tek AKSHI, brenda datës 31.12.2017 dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës.

AKSHI vendos në dispozicion të institucioneve të përmendura në shkronjën “i”, të pikës 6, personelin e mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fusha e veprimtimit të këtij vendimi.

24. Fondet buxhetore për shërbimet sipas shkronjës “i”, të pikës 6, të këtij vendimi, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, do të parashikohen në buxhetin vjetor të AKSHI-t. Për të gjitha institucionet jobuxhetore, AKSHI do t'i ofrojë shërbimet kundrejt tarifave.

Efektet financiare të kësaj pike fillojnë më 1 janar 2019.

25. Deri në miratimin e strukturës dhe të organikës së re, sipas këtij vendimi, AKSHI do të funksionojë sipas strukturës dhe organikës në fuqi.

26. Vendimi nr. 703, datë 29.10.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, vendimi nr. 303, datë 31.3.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit në ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë”, si dhe shkronja “g”, e pikës 1, e vendimit nr. 28, datë 14.1.2015, e Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, i ndryshuar, shfuqizohen.

27. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

Lista nr. 1

## KATALOG SHËRBIMESH

Shërbime qeveritare	Përshkrimi i shërbimit	Ofruesi i shërbimit	Marrësi i shërbimit
<b>Datacenter-i Qeveritar</b>	Datacenter-i Qeveritar siguron kushtet më optimale të energjisë, ftohjes, lidhjes dhe sigurisë për infrastrukturën qeveritare.	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Posta elektronike</b>	Shërbimi i ofrimit të postës elektronike zyrtare	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Shërbimet publike elektronike</b>	Ofrimi i shërbimeve publike elektronike në portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	AKSHI	Administrata publike, qytetarët, biznes
<b>Internet</b>	Shërbimi i internetit ofrohet me siguri të lartë në nivele të mirëpërcaktuara duke garantuar kushte teknike për shërbime të sigurta dhe <i>online</i> 24/7.	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Active Directory</b>	Active Directory ofron mundësinë për realizimin e menaxhimit dhe administrimit qendror të PC-ve dhe përdoruesve, si dhe integrimin e sistemeve për shërbimet të përqendruara.	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Hostimi për portale dhe faqe web</b>	Shërbimi i ofrimit të hostimit të portaleve/ <i>website</i> nëpërmjet serverave të dedikuar ose <i>shared hosting</i>	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Shërbim i lidhjes në rrjetin qeveritar</b>	GovNet është një rrjet privat qeveritar me fibër optike, i cili bën të mundur	AKSHI	Institucionet dhe organet e

<b>GOVNET</b>	komunikimin ndërmjet institucioneve qeveritare.		administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Komunikim i menjëhershëm: <i>instant messaging, audio, video dhe conference audio-video</i></b>	Nëpërmjet këtij shërbimi është e mundur të komunikohet nëpërmjet mesazheve tekst, audio dhe video të transmetuara në rrjet nga përdoruesit në kohë reale. AKSHI ka ndërtuar platformën <i>Microsoft Skype for Business</i> 2016, e cila realizon dhe bën të mundur ofrimin e këtij shërbimi.	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Platforma Qeveritare e Ndërveprimit (GG)</b>	Ndërveprimi i bazave të të dhënave shtetërore nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit	AKSHI	Çdo institucion publik dhe çdo personi fizik dhe juridik privat që ushtron funksion publik në përputhje me legjislacionin në fuqi
<b>Moduli për administratën publike në portalin <i>e-Albania</i></b>	Ofrimi i shërbimeve elektronike nëpërmjet modulit të portalit <i>e-Albania</i> për t'u përdorur nga nëpunësit e administratës publike që ofrojnë shërbime në sportel	AKSHI	Administrata publike, çdo personi fizik dhe juridik privat që ofron shërbime publike në sportel në përputhje me legjislacionin në fuqi
<b>Regjistrimi i bazave të të dhënave shtetërore</b>	Regjistrimi i bazave të të dhënave shtetërore në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", kuadrit plotësues të tij, si dhe VKM-së nr. 703, datë 29.10.2014, "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"	AKSHI	Çdo institucion publik dhe çdo personi fizik dhe juridik privat që ushtron funksion publik në përputhje me legjislacionin në fuqi
<b>Disaster recovery</b>	Ofrimi i një <i>site-i</i> dytësor në strukturën e AKSHI-t në raste fatkeqësish	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>EDRMS</b>	Sistemi i menaxhimit dhe monitorimit elektronik të korrespondencës shkresore mundëson automatizim të proceseve të punës	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>E-Aktet</b>	Sistemi e-Aktet mundëson digjitalizimin e procedurave të përgatitjes së akteve ligjore e	AKSHI	Këshilli i Ministrave, Kryeministria,

	nënligjore në funksion të vendimeve të Këshillit të Ministrave		ministratë e linjës
<b>Antivirus</b>	Ofrimi i shërbimit të mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike duke rritur sigurinë e pajisjeve kompjuterike	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Instalim i Certifikatës së Sigurisë SSL</b>	Nëpërmjet këtij shërbimi është i mundur instalimi i certifikatës së sigurisë SSL në <i>domain</i> -in GOV	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Nënshkrimi elektronik</b>	Autentifikimi dhe vërtetimi i identitetit /vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar elektronikisht	AKSHI	Administrata publike, subjektet/bizneset
<b>Vula elektronike</b>	Ofron vlefshmërinë ligjore një dokumenti elektronik	AKSHI	Administrata publike, subjektet/bizneset
<b>Asistencë për sistemet e-Gov</b>	Asistencë për: shërbim AD, DNS Private, DHCP, postë elektronike, licencim të produkteve <i>Microsoft</i>	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Asistencë për infrastrukturën e-Gov</b>	Asistencë për problematika të tilla, si: aksesimi i faqeve <i>web</i> , <i>back-up</i> i faqeve, serverave fizik dhe virtual, DNS Publike	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Asistencë për rrjetin e-Gov</b>	Asistencë për problematika të tilla, si: VPN, Fibër Optike, publikimi i faqeve, detektim/korrigjim i problemeve në rrjet	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>System Center Service Manager</b>	Ofron menaxhimin dhe ruajtjen e historikut të incidenteve teknike IT	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>System Center</b>	Menaxhim i qendëruar për aplikacionet/ <i>update</i> -	AKSHI	Institucionet dhe

<b>Configuration Manager</b>	et e pajisjeve kompjuterike të cilat janë pjesë e <i>domain</i> -it GOV		organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Data Protect Manager</b>	Sistemi i ruajtjes së informacionit ( <i>back-up</i> ) për infrastrukturat që hostohen pranë AKSHI-it dhe lehtëson rikuperimin e të dhënave në kohë reale	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Formatim PC</b>	Formatim i gjithë PC-ve të institucionit	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Konfigurim i PC-ve në rrjet</b>	Konfigurim i gjithë PC-ve të institucionit në rrjet	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Krijim <i>user</i>-i/ <i>computer</i> në AD</b>	Krijim i <i>user</i> -ave/kompjuterave të rinj në AD në bashkëpunim me sektorët e burimeve njerëzore	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Rivendosje fjalëkalimi</b>	Rivendosje fjalëkalimi të përdoruesve në AD	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Shtim i PC-ve në <i>domain</i>-in</b>	Shtim i PC-ve të institucionit në <i>domain</i> -in “gov.local”	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b><i>Software</i>/<i>Hardware</i></b>	Instalimi/modifikimi/riparimi i aplikacioneve dhe pjesëve fizike të PC-ve	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën

			përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Asistencë sistemesh</b>	Asistencë teknike për pyetjet/çështjet që kanë të bëjnë me sisteme të ndryshme	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Asistencë për mail (posta elektronike)</b>	Asistencë në konfigurim/përdorim të postës elektronike në PC/tableta/ <i>Smart Phone</i> të institucionit	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Printer/Skaner</b>	Instalim i printer/scaner-it në institucion	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Programe <i>Microsoft</i></b>	Asistencë për produktet e <i>Microsoft</i>	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Licencim <i>Microsoft</i></b>	Licencimi i produkteve <i>Microsoft</i>	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Hartimi i manualeve</b>	Hartimi i manualeve për sisteme të ndryshme të cilat i vijnë në ndihmë përdoruesve të sistemeve	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Trajnime</b>	Trajnim stafi për sisteme të ndryshme sipas nevojës	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave

			Ministrave
<b>Mirëmbajtje e rrjetit kompjuterik</b>	Mirëmbajtje e rrjetit kompjuterik të institucionit, të tilla si: ups, routers, switches, firewalls, kompjutera, printer, scanner	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Rrjeti lokal (LAN)</b>	Asistencë teknike për problemet që lidhen me rrjetin lokal	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Servera</b>	Instalimi/konfigurimi/mirëmbajtja e serverave të institucionit	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Pajisjet e rrjetit</b>	Identifikim i problemeve fizike të rrjetit për pajisjet që janë në pronësi të institucionit	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Back-up i lokalizuar</b>	<i>Back-up</i> të të dhënave (profilat, postës elektronike, skedarëve të ndryshëm) në kompjuterat e përdoruesve	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave
<b>Mbyllje aksesi</b>	Mbyllja e akseseve të përdoruesit në rast largimi nga puna dhe fshirja e përdoruesit/kompjuter nga AD	AKSHI	Institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave

**Lista nr. 2**

(Hequr emërtesat “Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS)” dhe “Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS) në gjykatat administrative” me VKM nr.36, datë 24.1.2018 )

Lista e institucioneve	Sistemi/Infrastruktura
Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	Sistemin WEBGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren të ASHA për vitet 2008-2015 (faza I)
	Zgjerimi i funksionaliteteve të ASHA-s WEBGIS për regjistrimin e aktivitetit arkeologjik në terren (faza II)
	Implementimi i sistemit të menaxhimit të dokumenteve për projektet dhe korrespondencës lidhur me to (faza III)
Agjencia Kombëtare e Trajtimit të Koncesioneve	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentimit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia e Prokurimit Publik	Sistemi i prokurimit elektronik
Agjencia e Trajtimit të Kredive	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia e Trajtimit të Pronave	Sistemi ATP-WebGIS
Agjencia e Zhvillimit të Territorit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësorë	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve e lejeve minerare mbi burimet natyrore në RSH
	Mirëmbajtja për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS
	Ngritja e infrastrukturës së <i>Disaster Recovery</i> dhe <i>Upgrade</i> në <i>site-in</i> primar
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Regjistri i Shkarkimit të Ndotësve në Mjedis (RRSHTN)
	Sistemi i monitorimit të informacionit mjedisor (EIMS)
	RAVEN
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit
	Sistemi e-planifikimi
Agjencia Kombëtare e Turizmit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	BIONNA
	SIMF
Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Sistemi i menaxhimit të informacionit për skemat kombëtare
	Sistemit i menaxhimit të informacionit për aplikimet në lidhje me “Projektin e Shërbimeve Mjedisore”
	Sistemi i menaxhimit të informacionit për programin IPARD 2014-2020 ( MIS IPARD 2014-2020 )
	Sistemi i menaxhimit të informacionit për programin IPARD-like
Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	Sistemi i Arkivit Digjital të AQTN
Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Autoriteti i Aviacionit Civil	Databazë e komunikimit elektronik dhe sistemi i integruar i menaxhimit të AAC-së
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	AKUnet (AKU <i>network</i> )

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Autoriteti për Informacionin Gjeohapësinor	Gjeoportali Kombëtar
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Implementimi i sistemit të menaxhimit të trafikut
	Instalimi i sistemit WEB - GIS në ARRSH
	Implementim i sistemit të menaxhimit të trafikut (vazhdimi) dhe instalimi i sendorëve peshë për aks
	Blerje pajisjesh kompjuterike për ARRSH
Avokatura e Shtetit	Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore
Biblioteka Kombëtare	Sistemi i integruar bibliotekar (ADLIB) Program i bibliotekës digjitale ( <i>Greenstone</i> )
Departamenti i Administratës Publike	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Menaxhimi i informacionit të Sistemit Penitenciar (MISP)
	Informatizimi i regjistrave themeltar të periudhës së dënimit
	Certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Sistemi i menaxhimit të projekteve
	Asycuda World
	Manage Engine
	Nagios
	ERDMS
	Limesurvey
	Domain
	Mail Server
	Firewall
	Sistemi i monitorimit të kamerave
	Oracle DB
	SLA-suport për sistemin Asycuda World
	SOClass
	LIMS
	DIS
NCTS	
ITMS	
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Sistemi i aksesit
	Sistemi i kamerave (1NVR+4 kamera IP)
	Sistem dedektim dhe shuarje zjarri me agentë të pastër
	Sistem monitorimi
	Sistemi i menaxhimit për qendrën e të dhënave
	Ndërtimi i ndërfaqes së komunikimit ndërmjet RKGJC dhe RKA
	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i portalit të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile
	Ndërtimi i sistemit dhe mirëmbajtja e RKA-s
	Zhvillimi i Sistemit RKGJC
Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	eForm
	Regjistri Kombëtar i Personave të Aftësuar

	për Drejtimin e Mjeteve - <i>Lejedrejtimi</i> <i>eCAP&amp; eDT</i>
	Regjistri Kombëtar i Mjeteve - <i>eDPSHTRR</i>
	Shërbimi i transmetimit të të dhënave
Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	Sistemi i Menaxhimi të Standardeve (SMS)
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore	Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore
Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	Sistemi i Monitorimit të Anijeve të Peshkimit
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Drejtoria Veterinare	RUDA
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Menaxhim <i>online</i> i depove Menaxhon <i>online</i> vizitat te QSH Menaxhon rekordet shëndetësore Krijimi i ambienteve për serverat
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve	Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve Pasaporta digjitale
Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Inspektorati Qendror	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Inspektorati Shtetëror Shëndetësor	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Instituti i Mjekësisë Ligjore	Sistemi i menaxhimit të akteve
Instituti i Monumenteve të Kulturës	WEB-GIS “Inventarizimi dhe hartëzimi i monumenteve të kulturës në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet hartës GIS”
Instituti i Shëndetit Publik	Sistemit informativ të vaksinimit (SIV)
Instituti i Sigurimeve Shoqërore	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Kryeministria	Sistemi EAMIS Sistemi IPSIS Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Platforma <i>e-learning</i> SITOS Sistemi i menaxhimit financiar (Financa 5) Portali “Mësues për Shqipërinë”
Ministria e Brendshme	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Ministria e Drejtësisë	Regjistri Noterial Shqiptar RNSH Regjistri i çështjeve përmbartimore ALBIS Arkiva për gjendjen gjyqësore të shtetasve shqiptarë nga institucionet e huaja Sistemi elektronik për digjitalizimin e arkivit gjyqësor Sistemi elektronik për <i>high availability</i> dhe menaxhimit të incidenteve Sistemi i mbikëqyrjes elektronike Databaza qendrore për bashkëpunimin ndërgjyqësor me jashtë Sistemi elektronik për certifikatën e gjendjes gjyqësore SEMD
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Sistemi e <i>Tax</i> Sistemi i pajisjeve fiskale Sistemi i hartës digjitale

	<p>Sistemi m-Tax</p> <p>Sistemi i menaxhimit të projekteve</p> <p>Sistemi informatik financiar i qeverisë (SIFQ). Është berë <i>upgrade</i> i infrastrukturës qendrore të sistemit (SIFQ) në shkurt të vitit 2016.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të dëshmëpërblimeve të të ish-të përndjekurve politikë</p> <p>Sistemi i shpenzimeve dhe investimeve të programit të buxhetit afatmesëm (PBA)</p> <p>Sistemi i menaxhimit të borxhit dhe analizës financiare (DMFAS)</p> <p>Sistemi i menaxhimit të investimeve publike (REMIP)</p> <p>Sistemi i <i>Alpha Web</i></p> <p>Sistemi i <i>Alpha PMR</i></p> <p>Sistemi AFMIS</p> <p>Administrimi elektronik i të dhënave për pronat shtetërore, të dhënat e zonave ekonomike dhe informatizimi i shërbimeve për pronat shtetërore (AEDHPSH)</p> <p>Regjistri i të Dhënave nga Sipërmarrjet Akomoduese Turistike (RDHSAT)</p>
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	<p>Ish-MEI: Sistemit Informatik për Administrimin dhe Automatizimin e Punëve dhe Proceseve në MEI (te ky sistem është i integruar dhe MIS i Koncesioneve)</p> <p>Sistemi informatik i integruar për shërbimet për licencimin pranë MZHU</p> <p>Sistemi informatik i integruar për licencimin pranë MZHU, në studim, projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të ndërtimit</p> <p>Harta digjitale e venddepozitimeve të mbetjeve urbane</p> <p>Sistemi i integruar për informatizimin e vlerësimit të pasurive të paluajtshme</p>
Ministria e Kulturës	<p>Sistemi i biletarive elektronike nëpër zonat e trashëgimisë kulturore</p>
Ministria e Mbrojtjes	<p>Sistemi elektronik i administrimit të dokumenteve të paklasifikuara (SEADP)</p> <p>Sistemi financiar “Alphaweb”</p> <p>Sistemi i Printimit i Përqendruar, Monitoruar dhe të Sigurt (SPPMS) i MM</p> <p>Sistemi i “Ruajtjes dhe Shkëmbimit të Dokumenteve Elektronike në rrjet” (RSHDE)</p> <p>Rrjeti kompjuterik i paklasifikuar për MM dhe sistemet mbështetëse të tij</p>
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	<p>Rekordi elektronik shëndetësor kombëtar</p> <p>Sistemi i regjistrimit të recetave elektronike kombëtare</p> <p>Sistemi i menaxhimit të stafit për sistemin shëndetësor</p> <p>Sistemi i regjistrimit dhe kontrollit të</p>

	barnave Sistemi i monitorimit të jodit në kripën ushqimore Nënshkrimi elektronik i dokumenteve mjekësore Sistemi i menaxhimit të informacionit për personat me aftësi të kufizuara Sistemi për administrimin e integruar të Shërbimeve Sociale Sistemi i menaxhimit të informacionit për ndihmën ekonomike Sistemi i mbledhjes dhe raportimit të informacionit shëndetësor të regjistrave mjekësorë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	<i>Upgrade</i> e sistemit financiar Alfa qendror dhe integrimi i 16 institucioneve të varësisë Pasaporta digjitale mjedisore Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Platforma “SHKO” (Shërbimi Konsullor Online) Sistemi Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Plani kombëtar për Integrimin European (Moduli Masat Kombëtare), ndarja e <i>Acquis</i> (moduli masat e BE-së) Sistemi TIK në mbështetje të procesit të anëtarësimit në Bashkimin European Trados - Sistemi i menaxhimit të procesit të përkthimit të legjislacionit ALTERM, baza e të dhënave terminologjike anglisht - shqip
Muzeu Historik Kombëtar	Biletaria elektronike Sistemi elektronik i portave hyrëse
Qendra e Botimeve Zyrtare	Sistemi i publikimit të Qendrës së Botimeve Zyrtare
Qendra e Shërbimeve Arsimore	Sistemi i Maturës Shtetërore Sistemi i provimeve të shtetit Sistemi i menaxhimit të informacionit në IAL
Qendra Kombëtare e Biznesit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore	Sistemi Informatik Kombëtar i Regjistrimit dhe Administrimit të Pasurive Kulturore Kombëtare, krijuar përmes projektit “Krijimi i qendrave të informimit publik për regjistrimin <i>online</i> të pasurive kulturore kombëtare”, investim i qeverisë shqiptare (agjenda digjitale)
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	Sistemi i menaxhimit të urgjencave (EMMA) dhe Centrali Telefonik për numrin 127
Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore	Mirëmbajtje e pajisjeve të sektorit të infrastrukturës Investime të sektorit të infrastrukturës Sistemi i menaxhimit të pajisjeve mjekësore

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe e Rrjetit Telematik	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë	SISP (Sistemi Informatik i Shëndetit Publik)
Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Sistemi GIS i ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave
Shërbimi i Provës	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Shtypshkronja e Letrave me Vlerë	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Spitali Elbasan	Sistemi i digjitalizimit të të dhënave mjekësore të pacientëve, ASTRAIA
Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë	Sistemi i digjitalizimit të të dhënave mjekësore të pacientëve, ASTRAIA
	Sistemi informativ i integruar për shëndetësinë
Spitali Universitar Shefqet Ndroqi	SISP
	QMATIC
	PACS
Teatri i Operas dhe Baletit	Të gjitha sistemet IT ekzistuese dhe të reja
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Konektiviteti për ALBSREP + ALBPOS
	Mirëmbajtje e sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në ZRPP
	Mirëmbajtje e modulit të përmirësimit të Nideve
	Përshtatja e <i>backend</i> -it për lidhjen me platformën qeveritare të ndërveprimit në lidhje me 51 shërbimet e ZVRPP sipas marrëveshjes me AKSHI-n